

V E N D I M
Nr. 39, datë 21.4.1999

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga :

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““

Me sekretare Arbenka Lalica e Drita Filto, më datat 23.3.1999 dhe 6.4.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.31 Akti që i përket :

KËRKUESA:

BEGLIJE MINAROLLI; KUDRETE HYSA; MURAT PETRELA; ENVER E AGIM PREZA; GAZMEND, MUSTAFA E ORMIR FORTUZI; VJOLLCA VELJA, të përfaqësuar nga avokatët Liljana Ruli e Roland Përmeti, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: TRESHEGIMTARET E SHEH ALI PAZARIT, të përfaqësuar nga avokat Riza Hicka, me prokurë.

O B J E K T I :

Shpallja antikushtetues i vendimeve nr.1319, datë 12.3.1997 të gjykatës së rrethit Tiranë; nr.1515, datë 11.6.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.1303, datë 7.11.1997 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit; nr.67 Akti, datë 18.12.1997 të gjykatës së rrethit Tiranë; nr.843, datë 6.5.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të datës 3.12.1998 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesve të palës kërkuese, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Në bazë të nenit 131 shkronja “f” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese, vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Me ligjin nr.8432, datë 14.12.1998 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, i cili ka hyrë në fuqi, është ndryshuar edhe neni 473 i Kodit të Procedurës Civile duke u përcaktuar se kundër vendimeve të formës së prerë, vendimeve të mospranimit të rekursit si dhe vendimeve të kolegjeve të Gjykatës së Lartë, palët kanë të drejtë të bëjnë rekurs në Kolegjet e Bashkuara.

Në këtë mënyrë kërkesit kanë edhe një mjet tjetër juridik të zakonshëm për të goditur vendimet nr.1319, datë 12.3.1997 të gjykatës së rrethit Tiranë; nr.1515, datë 11.6.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1303, datë 07.11.1997 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, si vendim i mospranimit të rekursit, të bëjnë rekurs në Kolegjet e Bashkuara.

Përsa i përket tre vendimeve të tjera që përmban kërkesa, ato kanë lidhje po me këtë çështje dhe nuk përbëjnë pengesë për ndjekjen e rrugës së re të zakonshme që është krijuar me ligjin e sipërpërmendur.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131, 132 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 41 të ligjit nr.8373, datë 15.07.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, unanimisht,

V E N D O S I :

Prëzimin e kërkesës për mungesë juridiksioni.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 21.4.1999

Nr. 31 i regjistrimit themeltar

Nr. 39 i vendimit